



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

Vendim

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 181/19)

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/16 dhe 50/19), në pikën 4, paragrafi 2 fshihet.

2. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

O nr. 02-15/VIII-1/2019
29 gusht 2019
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e Ligjit të Veprimtarisë me Valuta, Banka Popullore është e autorizuar që, nëpërmjet një akti nënligjor, të përcaktojë mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit.

Me Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit përcaktohen kushtet sipas të cilave personat fizikë rezidentë mund të çelin lirshëm llogari jashtë vendit në bazë lejes nga Banka Popullore, si dhe kushtet për çeljen e llogarive në shërbimet elektronike të huaja për transaksione pagesash.

Çelja dhe mbajtja lirshëm e llogarive në shërbimet elektronike për transaksione pagesash dhe vetëm për qëllime komerciale, përkatësisht për blerje/shitje të mallrave dhe të shërbimeve në mënyrë elektronike, është e mundur, por vetëm nëse është një shërbim elektronik për transaksione pagesash për të cilat bankat e autorizuar morën njoftimin nga Banka Popullore që, do të mund të çelin llogari përdoruesi. Në zbatimin e deritashëm të këtyre dispozitave, Banka Popullore i ka njoftuar bankat vetëm për mundësinë e çeljes së llogarive në PayPal dhe vetëm për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga jashtë.

Duke pasur parasysh rritjen e numrit të këtyre shërbimeve elektronike, globalizimin dhe digjitalizimin e pagesave, si dhe për hir të promovimit më të madh të tregtisë elektronike dhe të promovimit të mëtejshëm të përparësive të teknologjive financiare, me ndryshimet e këtij vendimi propozohet heqja e kufizimit të shërbimeve elektronike për transaksione pagesash në të cilat rezidentët mund të çelin dhe të kenë llogari përdoruesi.